

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6760
E enjte, 17 nëntor 2022
çmimi 0.40

Ministri i Mbrojtjes viziton ish-udhëheqësit e UÇK-së në Hagë



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

JAMIE SHEA: NATO-ja DUHET TA PËRFORCOJË MBROJTJEN PËR VETE



Të martën është raportuar se dy raketa të prodhimit rus kanë rënë në Poloni duke shkaktuar vdekjen e dy personave. Ish-zyrtari i NATO-s, Jamie Shea, thotë se sulmi me raketa në Poloni, i qëllimshëm ose jo, ka nxjerrë në pah nevojën që edhe vendet e NATO-s, sidomos ato në Evropën Lindore, ta përforcojnë mbrojtjen ajrore. "Mendoj se

NATO-ja duhet të drejtohet kah industria, kah qeveritë, për të parë se si mund ta rrisë prodhimin e gjërave si: sistemi gjerman IRIS-T, sistemi amerikan i mbrojtjes ajrore Patriot e të tjera. Ka disa të tillë në Evropën Lindore. Por, qartazi, kemi nevojë për shumë më tepër", ka theksuar ish-zëdhënës i NATO-s, Jamie Shea

AKTUALE



BE-ja NË PRITJE TË PËRGGJIGJES SË PRISHTINËS RRETH PROPOZIMIT TË RI PËR TARGAT SERBE F. 5

TRUMPI SHPALL KANDIDATURËN PËR PRESIDENT MË 2024 F. 2

KOMUNA E DRENASIT FITON ÇMIMIN EVROPIAN PËR QEVERISJE TË SHKËLOYER F. 6

EKONOMI



PDK-ja: PROJEKTBUXHETI I VITIT 2023, BUXHET I VARFËRISË DHE JOZHVILLIMOR F. 8

BQK-JA: NORMA MESATARE E INFLACIONIT MË 2023 PRITET TË BIE NË 6.2 PËR QIND F. 8

SPORT



'DARDANËT' NDAHEN BARAS ME ARMENINË F. 10



ABDIXHIKU: LDK-ja E SHOQËTËSUAR ME DEGRADIMIN E RAPORTEVE KOSOVË - SHBA



BUXHETI PËR FSK-NË PËR VITIN E ARDHSHËM PRITET TË JETË 123 MILIONË EURO

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
E-mail: renova@mt.net.mk
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Raketat që ranë në Poloni “u hodhën nga Ukraina”

VARSHAVË, 16 NËNTOR - Agjencia e lajmeve “Associated Press” citoi tre zyrtarë amerikanë të kenë thënë se një vlerësim paraprak sugjeron se raketat që goditën Poloninë të martën u hodhën nga forcat ukrainase që po luftojnë kundër forcave pushtuese ruse.

Zyrtarët folën në kushte anonimiteti, pasi thanë se nuk janë të autorizuar për të diskutuar publikisht për këtë çështje.

Presidenti i Polonisë, Andrzej Duda, tha të mërkurën se nuk ka asnjë indikacion që shpërthimi i së martës në Poloni, që vrau dy persona, të ketë qenë “sulm i qëllimshëm”, duke shtuar se më shumë gjasë ka që të ketë qenë vetëm një fatkeqësi. Ai shtoi se besohet që raketa e cila goditi një fshat kufitar në Poloni ishte e mbrojtjes ajrore ukrainase por, gjithashtu, tha se përgjegjësia



përfundimtare i takon Rusisë, që nisi një varg sulmesh me raketa drejt Ukrainës të martën. “Absolutisht asgjë nuk jep indikacione që ky ishte një sulm i

qëllimshëm mbi Poloninë... Ka shumë gjasa që ishte një raketë e përdorur për mbrojtje, që do të thotë se po përdorej nga forcat e mbrojtjes të Ukrainës”, tha Duda

të mërkurën.

Ministria e Jashtme e Polonisë tha se një raketë e prodhuar nga Rusia ra në fshatin Przewodow, në Poloninë lindore, rreth gjashtë

kilometra larg kufirit me Ukrainën, duke vrarë dy persona më 15 nëntor, pas një dite granatimesh masive ruse të Ukrainës.

Ndërsa kryeministri i Polonisë, Mateusz Morawiecki, tha se Polonia është ende duke e shqyrtuar mundësinë e aktivizimit të Nenit 4 të NATO-s, por shtoi se duket që një gjë e tillë të mos jetë e nevojshme. Sipas këtij neni, vendet anëtare mund të ngrenë shqetësimin kur ndiejnë se “integriteti territorial, pavarësia politike ose siguria e tyre” janë në rrezik. Ndërsa Neni 5 i Traktatit të NATO-s thotë se sulmi ndaj një vendi anëtar të aleancës ushtarake është sulm ndaj të gjithëve.

Presidenti i ShBA-së, Joe Biden, thirri një takim të liderëve të mbledhur në Bali të Indonezisë për samitin e grupit të vendeve më të industrializuara, G20.

Trumpi shpall kandidaturën për president më 2024



UASHINGTON, 16 NËNTOR - Ish-presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, shpalli zyrtarisht kandidaturën e tij për zgjedhjet presidenciale në vitin 2024. “Rikthimi i Amerikës fillon pikërisht tani”, u tha Trumpi mbështetësve në resortin e tij Mar-A-Lago në Florida.

Njoftimi vjen një javë pas zgjedhjeve të mesmandatit në ShBA, të cilat përcaktojnë përbërjen e Dhomës së Përfaqësuesve dhe të Senatit amerikan.

Partia Republikane e Trumpit doli më keq seç pritej në këto zgjedhje dhe shumë prej kandidatëve që ai mbështeti nuk arritën të fitonin.

Trumpi, manjat i pasurive të patundshme, befasoi me fitoren e tij në zgjedhjet e vitit 2016, kur mundi ish-sekretaren amerikane të Shtetit, Hillary Clinton. Ai tha se nuk

po garon sërish për shkak të politikës, por për shkak të dashurisë së tij për Shtetet e Bashkuara. “Për ta bërë Amerikën përsëri të madhe dhe të lavdishme, unë po shpall kandidaturën time për president të Shteteve të Bashkuara”, tha Trumpi. Gjatë katër vjetëve në Shtëpinë e Bardhë, Trumpi bëri histori si presidenti i parë që u akuzua dy herë formalisht. Herën e parë ai u akuzua për abuzim të pushtetit dhe pengim të punës të Kongresit Amerikan, por më pas u lirua nga këto akuza.

Herën e dytë akuzat kishin të bënin me sulmin e mbështetësve të tij kundër Kongresit Amerikan më 6 janar 2021, në përpjekje për ta penguar tranzicionin paqësor të pushtetit të presidentit, atëherë i zgjedhur, Joe Biden. Hetimet për këtë ngjarje janë duke vazhduar.

Zelensky: Rusia s’ka interesim për ta përfunduar luftën

KIEV, 16 NËNTOR - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, tha se sulmet ruse me raketa, që goditën të martën disa qytete të Ukrainës, tregojnë se Moska “nuk ka interesim për ta përfunduar luftën”.

Zelensky tha se ushtria ruse lëshoi 90 raketa, duke dëmtuar infrastrukturën e energjisë si dhe bizneset dhe ndërtesat e banimit. “Kjo është përgjigja e Rusisë ndaj Indonezisë, Indisë, Kinës dhe të gjitha vendeve të tjera, që kanë folur për nevojën për t’i dhënë fund

luftës. Rusia po i thotë botës se dëshiron të vazhdojë. Tani është koha që bota të përgjigjet”, tha Zelensky përmes një video-adresimi.

Zelensky tha se sulmet kanë çuar në ndërprerje të energjisë elektrike në të gjithë Ukrainën, përfshirë rajonet e Kievit, Lvivit, Harkivit dhe Zhitomirit.

Ai, po ashtu, tha se më shumë se 70 raketa dhe 10 dronë luftarakë janë rrëzuar nga forcat ukrainase dhe falënderoi të gjithë partnerët që, siç tha, “ndihmojnë në mbrojtjen e

qiellit”.

Rusia ka nisur pushtimin në shkallë të gjerë të Ukrainës në fund të shkurtit.

Perëndimi e ka dënuar ashpër sulmin dhe ka ndërmarrë sanksione të ashpra kundër Rusisë. Ukrainën, në anën tjetër, është duke e ndihmuar me armatim.

Të martën ka pasur raporte se dy raketa të prodhimit rus kanë rënë në Poloni - vend anëtar i NATO-s - duke shkaktuar vdekjen e dy personave.

Këto raporte janë duke u hetuar.



Ministri i Mbrojtjes viziton ish-udhëheqësit e UÇK-së në Hagë

“Të gjithë me moral të lartë e të fortë ashtu siç ka qenë ushtria e popullit tonë, Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Ne besojmë pa asnjë hamendësim në pafajësinë e të gjithëve dhe në pastërtinë e luftës sonë çlirimtare”, ka thënë ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, pas vizitës që u ka bërë në Hagë ish-udhëheqësve të UÇK-së

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

HAGË, 16 NËNTOR - Gjatë qëndrimit në Holandë, ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka vizituar në Hagë ish-udhëheqësit e UÇK-së, të cilët po mbahen të paraburgosur në Gjykatën Speciale. “Kam takuar të paraburgosurit e Gjykatës Speciale të cilët janë padrejtësisht duke u gjykuar në Hagë. Kam takuar Rexhep Selimin, Jakup Krasniqin, Kadri Veselin, Hashim Thaçin, Nasim Haradinajn dhe Pjetër Shalën, ndërsa kam biseduar shkurt edhe me Hysni Gucatin i cili është duke u përballur me probleme shëndetësore”, ka shkruar Mehaj në “Facebook”.

Ai ka treguar që në takimet që ka realizuar me secilin, i ka njoftuar me zhvillimet në vend, veçanërisht për zhvillimet në Ministrinë e Mbrojtjes, përkatësisht Ushtrinë e Republikës së Kosovës, ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe operacionale, bashkëpunimin me partnerët, rekrutimet, synimin për anëtarësim në PFP dhe NATO, të cilat, sipas ministrit Mehaj, janë në funksion të plotë të ruajtjes së paqes dhe mbrojtjes së gjithë territorit të Republikës sonë. “Të gjithë me moral të lartë e të fortë ashtu siç ka qenë ushtria e popullit tonë, Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Ne besojmë pa asnjë hamendësim në pafajësinë e të gjithëve dhe në pastërtinë e



luftës sonë çlirimtare. Gjithashtu, ndajmë bindjen e thellë që gjykimi i tyre është i padrejtë. Ne do të jemi gjithnjë krenarë me luftën e UÇK-së. ka qenë UÇK-ja ajo që na ka bërë

bashkë për ta fituar lirinë tonë. Në këtë pikë do të mbetemi përherë bashkë dhe kjo do të mbetet e pandryshuar përgjithmonë. Uroj që të gjithë të lirohen sa më shpejt. Ditët e së

ardhmes së Republikës sonë qofshin sikur pikturat e Rexhës - sa të bukura aq përmbajtjesore! Ushtria Çlirimtare e Kosovës do të dalë sërish fitimtare”, ka shkruar Mehaj.

Abdixhiku: LDK-ja e shqetësuar me degradimin e raporteve Kosovë - ShBA



Uashington, 16 nëntor - Delegacioni i Lidhjes Demokratike të Kosovës, i udhëhequr nga kryetari Lumir Abdixhiku, ka zhvilluar takime të rëndësishme në Departamentin e Shtetit në ShBA. Ditën e parë të vizitës në ShBA delegacioni i LDK-së, në krye me Abdixhikun, e filloi në Departamentin Amerikan të Shtetit, ku u prit nga Gabriel Escobar, zëvendësndihmëssekretar i Shtetit dhe i dërguari i posaçëm i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor. “LDK-ja është mirënjohëse për ndihmesën

historike dhe aktuale të Qeverisë së ShBA-së, të institucioneve të tjera dhe të popullit amerikan për Republikën e Kosovës. Së bashku, deri më tani, kemi arritur rezultate historike, mbi të cilat duhet të sigurohet e ardhmja e Kosovës si shtet i barabartë me të gjitha shtetet e tjera të botës. Kosova, shtet i pavarur e sovran, e anëtarësuar në NATO e BE dhe në miqësi të përhershme me ShBA-në, është misioni ynë i pandryshuar”, ka thënë Abdixhiku. Ai shtroi kërkesën për arritjen dhe nënshkrimin e Kartës për

Partneritet Strategjik ndërmjet ShBA-së dhe Kosovës. Kjo kartë bilaterale partneriteti siguron avancimin e relacioneve mes dy shteteve në mbrojtje, politikë, energjetikë, edukim, ekonomi, kulturë e të drejta të njeriut. Karta në fjalë avancohet në nivel të ri marrëdhëniet bilaterale mes dy shteteve, siç dhe ofron garanci të shëndosha për të ardhmen euroatlantike të Kosovës e regjionit. Abdixhiku në emër të LDK-së dhe qytetarëve të Kosovës, Escobarit i prezantoi dhe pikëpamjet e LDK-së mbi

gjendjen e fundit të sigurisë në Kosovë, si dhe nevojën e koordinimit të ngushtë të institucioneve të Kosovës me ShBA-në dhe me partnerët e tjerë. Koordinimi i tillë është garanci për t'i kapërcyer të gjitha sfidat. Në frymën e diskutimit miqësor me nikoqirin në Departamentin e Shtetit, kryetari Abdixhiku edhe një herë shprehu shqetësimin e tij dhe të LDK-së për shkallën në të cilën institucionet e Kosovës e kanë degraduar raportin me qeverinë amerikane. “Për shtetin tonë të ri, aleanca me ShBA-në

është jetike. Kështu ka qenë tash e më shumë se tri dekada. Aleanca dhe bashkëpunimi i ngushtë me ShBA-në dhe me partnerët evropianë, Kosovës ia kanë sjellë lirinë dhe pavarësinë. Populli i Kosovës është përjetë mirënjohës për të gjithë angazhimin e partnerëve tanë. Edhe një herë u bëj thirrje institucioneve të vendit që të bashkëpunojnë ngushtë me ShBA-në dhe partnerët e tjerë, në funksion të shtrirjes së sundimit të ligjit në të gjithë territorin e Kosovës, të sigurisë dhe të prosperitetit për të gjithë”, ka deklaruar Abdixhiku.



Jamie Shea: NATO-ja duhet ta përforcojë mbrojtjen për vete

Të martën është raportuar se dy raketa të prodhimit rus kanë rënë në Poloni, duke shkaktuar vdekjen e dy personave. Ish-zyrtari i NATO-s, Jamie Shea, thotë se sulmi me raketa në Poloni, i qëllimshëm ose jo, ka nxjerrë në pah nevojën që edhe vendet e NATO-s, sidomos ato në Evropën Lindore, ta përforcojnë mbrojtjen ajrore. “Mendoj se NATO-ja duhet të drejtohet kah industria, kah qeveritë, për të parë se si mund ta rrisë prodhimin e gjërave si: sistemi gjerman IRIS-T, sistemi amerikan i mbrojtjes ajrore Patriot e të tjera. Ka disa të tillë në Evropën Lindore. Por, qartazi, kemi nevojë për shumë më tepër”, ka theksuar ish-zëdhënës i NATO-s, Jamie Shea

PRISHINË, 16 NËNTOR - Ish-zyrtari i NATO-s, Jamie Shea, thotë se sulmi me raketa në Poloni, i qëllimshëm ose jo, ka nxjerrë në pah nevojën që edhe vendet e NATO-s, sidomos ato në Evropën Lindore, ta përforcojnë mbrojtjen ajrore. Të martën ka pasur raporte se dy raketa të prodhimit rus kanë rënë në Poloni, duke shkaktuar vdekjen e dy personave. Rusia, e cila ka nisur pushtimin e Ukrainës në fund të shkurtit, ka mohuar çdo përgjegjësi. Sipas disa raporteve, raketat që kanë rënë në Poloni mund të jenë hedhur edhe nga Ukraina gjatë përpjekjeve të saj për t'u mbrojtur nga sulmet ruse. Polonia dhe aleatë të NATO-s kanë nisur tashmë hetimet.

Shea, duke folur për “Radion Evropa e Lirë”, thotë se nuk pret që akti në territorin polak të çojë në zbatimin e Nenit 5 të NATO-s. Ky nen thotë se sulmi ndaj një vendi anëtar nënkupton sulm ndaj NATO-s dhe, rrjedhimisht, nxit reagimin e gjithë aleancës. “Asgjë nuk mund të përjashtohet, por nuk shoh ndonjë gjë që do të bëjë që Neni 5 të zbatohet në të ardhmen e afërt”, thotë Shea, ish-zëvendës i ndihmësit të sekretarit të përgjithshëm të NATO-s.

Fillimisht, cili ishte mendimi juaj i parë kur dëgjuat lajmin se dy raketa ranë në territorin e Polonisë?

Jamie Shea: Për mua ka qenë shumë e pritur që, herët e vonë,

raketat do ta kalonin kufirin e Polonisë. Kjo padyshim se është pasojë e sulmeve të pamatura ruse. Por, në anën tjetër, si ish-zëdhënës i NATO-s, që jam marrë me Ballkanin, mësimi që kam nxjerrë është: mos jep fakte pa i ditur ato. Situata mbrëmë [15 nëntor] ka qenë e errët. Natyrisht se duhet të ketë hetime. Dhe natyrisht se NATO-ja nuk mund të marrë ndonjë vendim përpara se të bëhen hetimet dhe faktet të jenë të qarta.

Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, tha se është e mundur që këto raketa të mos jenë hedhur nga Rusia...

Jamie Shea: Po, padyshim që ka marrë informacione nga

shërbimet e tij të inteligjencës sepse, përndryshe, nuk do ta thoshte këtë. NATO-ja ka avionë në qiell, amerikanët kanë sensorë, kanë satelitë, ata janë në gjendje t'i gjurmojnë rrugët e fluturimit të raketave, t'i gjurmojnë të dhënat. Këto mund t'u kenë dhënë atyre indikacione. Nuk mendoj se presidenti Biden do ta bënte atë deklaratë publike nëse nuk do të mendonte se ka arsye për ta bërë. Siç e dini, ukrainasit kanë hedhur shumë raketa për mbrojtje dhe kanë pasur njëfarë suksesi. Ata pretendojnë se rrezojnë nganjëherë 70 % të dronëve dhe raketave që Rusia i gjuan në drejtim të tyre. Pra, janë shumë aktivë. Dhe, hipoteza se një raketë ukrainase nuk ka funksionuar dhe ka pasur pasojë tragjike, nuk mund të përjashtohet. Por, këtu duhet theksuar edhe diçka: ukrainasit nuk do të qëllonin, sikur Rusia të mos i sulmonte.

Pyetem se cila do të jetë përgjigjja e NATO-s? Në të dyja rastet, edhe nëse konstatohet se ka qenë veprim i qëllimshëm, ose aksidental...

Jamie Shea: Ambasadorët e NATO-s takohen sot. Ata, padyshim, do të duan të dëgjojnë

nga Polonia për hetimet deri tash, se si po bëhen ato. Amerika ka ofruar disa ekspertë për të ndihmuar dhe vendet e tjera mund ta bëjnë të njëjtën. Vendet e NATO-s do të tregojnë solidaritet dhe unitet në mbështetje të Ukrainës. Mendoj se Rusia do të kritikohet fuqishëm. Siç e thashë, edhe nëse rusët nuk janë drejtpërdrejt përgjegjës për këtë sulm, ai ka ndodhur sepse Rusia ka pushtuar Ukrainën. Nuk do të kishim raketa që hidhen në kufirin Ukrainë - Poloni, nëse Rusia nuk do të kryente sulme të tilla cinike dhe shkatërruese, të cilat kanë shënjestra civile. Synojnë ta shkatërojnë infrastrukturën energjetike.

Mendoj se do të ketë një dënim të Rusisë dhe ndoshta një lloj paralajmërimi për të, që t'i ndalojë sulmet, sepse pasojat e përhapjes së konfliktit, pas incidentit të djeshëm, janë të qarta. Po ashtu, mendoj se Polonia dhe aleatët e tjerë në Evropën Lindore do të bëjnë thirrje për më shumë mbrojtje ajrore nga NATO-ja. Duket qartë se nuk është vetëm Ukraina që ka nevojë për më shumë mbrojtje ajrore. Marrë parasysh cenueshmërinë e

BE-ja në pritje të përgjigjes së Prishtinës rreth propozimit të ri për targa serbe



PRISHTINË, 16 NËNTOR - Bashkimi Evropian është në pritje të përgjigjes së Kosovës për një propozim lidhur me çështjen e targave serbe, që gjatë ditës së martë i dërguari i Posaçëm për dialogun, Miroslav Lajçak, ia ka prezantuar kryenegociatorit të Kosovës për dialog, Besnik Bislimi, gjatë takimit të tyre në Bruksel. Kështu kanë thënë për "Radion Evropa e Lirë" burimet diplomatike në BE, por pa dhënë detaje për propozimin në fjalë. Burimet kanë konfirmuar se fjala është për propozimin për ta zgjidhur urgjentisht çështjen e zbatimit të vendimit për ndërrimin e targave ilegale të Serbisë në mënyrë që të

shmangen tensionet në veri të Kosovës.

Kryenegociatori i Kosovës në dialogun me Serbinë, Besnik Bislimi, tha më 16 nëntor në Prishtinë se "ka elemente që i kemi diskutuar për mundësinë për dalje nga kriza, por nuk ka dakordim". Ai theksoi se nuk e di se çka do të ndodhë më 21 nëntor, sepse "jemi në bisedime".

Qeveria e Kosovës nga 1 nëntori ka nisur zbatimin e planit të saj për reregjistrimin e makinave me targa ilegale serbe, në targa RKS, Republika e Kosovës.

Faza e dytë do të zbatohet nga 21 nëntori dhe parasheh gjoba deri në 150 euro për të gjithë shoferët e automjeteve me targa ilegale

serbe.

Qeveria e Kosovës do që këto automjete të reregjistrohen me targa të Republikës së Kosovës, RKS, por Serbia kundërshton, duke këmbëngulur në targa neutrale ndaj statusit të Kosovës. Në rast se pala kosovare jep përgjigje gjatë ditës për këtë propozim, dhe varësisht nga ajo përgjigje, i dërguari i BE-së për dialogun, Lajçak, mund ta vizitojë Beogradin për të biseduar edhe me palën nga Serbia.

Burimet e BE-së kanë përsëritur atë që më herët e kishte thënë edhe përfaqësuesi i lartë për politikë të jashtme dhe siguri, Josep Borrell, se duhet gjithsesi të arrihet një zgjidhje para datës 21

nëntor.

Një prej mundësive që përmenden nga burimet diplomatike është që të zgjatet afati kohor për ndërrimin e targave, edhe për dhjetë muaj, por pala kosovare, sipas të njëjtave burime, ka kërkuar nga BE-ja edhe sqarime se si do të jetë qëndrimi i saj pasi të skadonte një afat i tillë.

BE-ja nuk e vë në dyshim të drejtën e Kosovës për t'i zëvendësuar targa të veturave, por deri më tash ka kërkuar që kjo të bëhet duke respektuar afatet kohore për të cilat BE-ja mendon se kanë afat edhe dhjetë muaj.

Gjatë një diskutimi me temën "Raporti i Zgjerimit: Çfarë ka në të

për Kosovën?", të organizuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, në Prishtinë, Besnik Bislimi tha se të gjithë hapat që janë duke u ndërmarrë në raport me situatën e krijuar në komunat veriore, janë për të vendosur ligjin, por mundësisht pa krijuar tensione.

Ndryshe, plani i qeverisë parasheh që të gjitha makinat me targa serbe të konvertohen në targa të Kosovës deri më 21 prill të vitit 2023.

Janë rreth 9 000 makina me targa të tilla që qarkullojnë në veriun e Kosovës - të banuar me shumicë serbe - që nga paslufta më 1999.

Në shenjë kundërshtimi lidhur me vendimin e Qeverisë së Kosovës, nga 5 nëntori serbët janë larguar nga institucionet e Kosovës në katër komunat në veri: Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan.

Dorëheqje kanë dhënë edhe kryetarët e këtyre komunave.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka shpallur 18 dhjetorin datë të mbajtjes së zgjedhjeve në këto komuna të banuara me shumicë serbe. Por, derisa Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në Kosovë ka nisur përgatitjet për organizimin e zgjedhjeve të parakohshme lokale në komunat në veri të Kosovës, Lista Serbe ka thënë se kjo parti dhe qytetarët që e mbështesin atë, nuk do të jenë pjesë e këtij procesi zgjedhor.

Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian i kanë bërë thirrje Qeverisë së Kosovës që të mos nisë zbatimin e fazës së dytë për targa që parasheh gjoba deri në 150 euro.

territorit, [vendet] e NATO-s kanë, po ashtu, nevojë për mbrojtje.

Mendoj se kjo do të jetë një çështje delikate për aleancën [e NATO-s], sepse sa më shumë sisteme të mbrojtjes ajrore që mban për vete, aq më pak mund të dërgojë në Ukrainë. E Ukraina ka nevojë për to urgjentisht. Mendoj se NATO-ja duhet të drejtohet kah industria, kah qeveritë, për të parë se si mund ta rrisë prodhimin e gjërave si: sistemi gjerman IRIS-T, sistemi amerikan i mbrojtjes ajrore Patriot e të tjera. Ka disa të tillë në Evropën Lindore. Por, qartazi, kemi nevojë për shumë më tepër.

Po Neni 5 i Traktatit të NATO-s? A ka gjasa të zbatohet, nëse konstatohet se akti në Poloni ka qenë i qëllimshëm?

Jamie Shea: Ekziston gjithmonë kjo mundësi, nëse konstatohet - siç e thatë edhe ju - se ky ka qenë një sulm i qëllimshëm i Rusisë në Poloni. Por, rrethanat - për mendimin tim të paktën - nuk e plotësojnë këtë kriter. Për më tepër, nuk e dimë sigurt se ky ka qenë një sulm rus. Nëse po, nuk e dimë nëse ka qenë i qëllimshëm. Nuk duket se ka gjasa që Rusia - nëse ka kryer sulm të qëllimshëm

- do ta sulmonte fermën në Poloni përpara ndonjë instalimi ushtarak ose strategjik.

Dhe, në fakt, Polonia ka qenë shumë e kujdesshme deri më tash. Nuk kemi dëgjuar kërkesë të kryeministrit polak për ta zbatuar Nenin 5. Ata kanë folur vetëm për Nenin 4, që parasheh konsultime emergjente në NATO. Unë mendoj se aleanca do të dëshirojë t'i dërgojë një sinjal të fuqishëm Moskës por, në këtë fazë, pa e përshkallëzuar konfliktin në ndonjë mënyrë. Asgjë nuk mund të përjashtohet, por nuk shoh ndonjë gjë që do të bëjë që Neni 5 të zbatohet në të ardhmen e afërt.

Moska ka thënë se raportet [për sulmin në Poloni] janë një provokim. Cilët mendoni se do të jenë hapat e saj të ardhshëm?

Jamie Shea: Ajo që shohim është se rusët janë duke u sjellë në një mënyrë tepër të pamatur. Lëshimi i 112 raketave derisa zhvillohet samiti i vendeve më të industrializuara, G20, në Indonezi; ministri i Jashtëm rus, Sergei Lavrov, që lë takimin më herët, përpara se të nisnin sulmet me raketa; presidenti rus, Vladimir Putin, jo i pranishëm atje, i izoluar... Duket sikur Rusia - nëse



mund ta përdor këtë shprehje - po ia çon gishtërinjtë komunitetit ndërkombëtar dhe po i thotë: Nuk brengosemi, nuk shqetësohemi për pasojat.

Por, në anën tjetër, fakti që Polonia tani është prekur, do t'i bëjë disa vende si Kina, India, Indonezia dhe të tjera të G20-s - që kanë hezituar ta ndëshkojnë Rusinë - të fillojnë dhe të mendojnë nëse

dhënia e ndonjë lloji ndihme apo mbështetjeje për Putinin është gjë e mençur. Rusia, si gjithmonë, do ta mohojë [përgjegjësinë], do të veprojë në mënyrë sfiduese, do të silltet sikur nuk brengoset, por pasojë do të jetë izolimi i mëtejshëm rus. Dhe, siç e thashë, kjo do ta bëjë më të vështirë për vendet si Kina apo India, që të tregojnë ndonjë simpati për

Putinin.

Ndoshta do të ketë edhe sanksione shitesë [kundër Rusisë], që do të ndërmerren më shpejt. Dhe, po, përforcime të mbrojtjes ajrore të NATO-s, gjë të cilën Putini me siguri se nuk do ta konsiderojë si interes të Rusisë. Pra, qasje e ashpër ndaj Moskës. Në aspektin strategjik, ky do të jetë një komplikim i madh për Rusinë.

Komuna e Drenasit fiton Çmimin Evropian për Qeverisje të Shkëlqyer

DRENAS, 16 NËNTOR - Kryetari i komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka bërë me dije se është njoftuar nga Shoqata Evropiane për Demokraci Lokale se komuna e Drenasit është shpërblyer me Çmimin Evropian për Qeverisje të Shkëlqyer. “Komuna e Drenasit me qeverisje të shkëlqyer, merr edhe një çmim nga Shoqata Evropiane për Demokraci Lokale - Alda. Kjo shoqatë na ka informuar se komuna e Drenasit është vlerësuar e para në Kosovë me Çmimin Evropian për Qeverisje të Shkëlqyer. Dua t’i falënderoj zyrtarët dhe drejtuesit e Shoqatës Evropiane për Demokraci Lokale - Alda për vlerësimin, zyrtarët

përgjegjës të komunës së Drenasit dhe kontribuuesit të cilët me përkushtim kanë zbatuar parimet e garës ku ne kemi fituar këtë çmim prestigjioz”, ka shkruar Lladrovci në “Facebook”. Ai ka thënë se komuna e Drenasit ka arritur nivel të lartë të qeverisjes dhe me përkushtim i ka përmbushur të 12 parimet e Këshillit të Evropës në kuadër të Qeverisjes së Mirë Demokratike. “Javën tjetër në Shkup organizohet solemniteti ku jemi ftuar për ta marrë Çmimin Evropian për Qeverisje të Shkëlqyer të cilin e jep Shoqata Evropiane për Demokraci Lokale me seli në Strasburg”, ka bërë me dije Lladrovci.



Asfaltohen tetë rrugë në fshatin Haxhaj të Gjilanit

GJILAN, 16 NËNTOR - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, së bashku me drejtorin e Shërbimeve Publike, Mentor Mihovci, ka vizituar punimet e asfaltimit të rrugëve në Haxhaj. Kryetari Hyseni ka bërë me dije se janë asfaltuar tetë rrugë në kuadër të projektit i cili kap vlerën e 111

mijë euro. “Punimet në asfaltimin e rrugëve po përfundojnë edhe në fshatin Haxhaj. Tetë rrugë janë asfaltuar, duke realizuar kështu projektin i cili arrin shumën mbi 111 mijë euro. Infrastruktura po e ndërtojmë edhe në fshatra”, ka thënë Hyseni.

Nis shenjëzimi i parkingjeve në Skenderaj

SKENDERAJ, 16 NËNTOR - Pas përfundimit të shenjëzimit të hapësirave për parking për banorët rezidentë të objekteve banesore në rrugën “Fehmi e Xhevë Lladrovci” në Skenderaj, ka nisur shenjëzimi tjetër i parkingjeve edhe për banorët e ndërtesës në rrugën “Ahmet Delia”, afër sheshit “Adem Jashari”. Me këtë rast, kompania e kontraktuar, nën mbikëqyrje të inspektorëve nga

Drejtoria e Inspektionit, ka përfunduar procesin e shenjëzimit, duke hapur rrugë kështu procesit të aplikimit për parking nga ana e banorëve rezidentë. Hapësira parkingu e dedikuar për banorët rezidentë të objekteve banesore në qytet ka qenë premtim i qeverisjes Nura gjatë fushatës parazgjedhore, i cili premtim tashmë veçse po përmbushet.



Fillojnë punët në lokalitetin arkeologjik në sheshin e Lidhjes së Prizrenit

PRIZREN, 16 NËNTOR - Kanë filluar punët në pastrimin e Lokalitetit Arkeologjik në sheshin e Lidhjes së Prizrenit dhe hapësira po bëhet gati për pjesën e parë të konservimit. Në projektin e financuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, procesi i hartimit është zhvilluar nga grupi i mandatuar punues i përbërë nga Instituti Arkeologjik i Kosovës, Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturor në Prizren dhe Departamenti për Trashëgimi Kulturor i Ministrisë së Kulturës, komuna e Prizrenit dhe është udhëhequr nga Zyra e UN-Habitat-it në Kosovë. Në këtë proces përmes analizave

të zonës dhe diskutimeve publike janë përfshirë banorët, komuniteti i biznesit dhe komuniteti profesionist në mënyrë që prezantimi final i Lokalitetit Arkeologjik të jetë reflektim i një zgjidhjeje të përbashkët. Projekti i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit mbështetet nga UN-Habitat Kosovë përmes Programit të Zhvillimit Gjithëpërfshirës të financuar nga Qeveria e Suedisë dhe synon integrimin e trashëgimisë kulturore në kuadër të planifikimit hapësinor për zhvillim të qëndrueshëm, të gjelbër dhe gjithëpërfshirës.



Kardiokirurgë dhe kardiologë amerikanë po operojnë fëmijët me probleme në zemër në Kosovë

PRISHTINË, 16 NËNTOR - Ushtruesja e detyrës e drejtorit të përgjithshëm të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, Pranvera Zejnullahu-Raçi, ka vizituar Spitalin e Kirurgjisë Pediatrike në QKUK, aty ku kardiokirurgë dhe kardiologë

amerikanë po i trajtojnë fëmijët me probleme në zemër.

Mjekët e organizatës "Gift of Life International" kanë ardhur në Kosovë ditën e diel dhe deri tani kanë kryer pesë operacione kardiokirurgjike dhe dhjetë intervenime

kardiologjike te pacientët. Ata do të qëndrojnë në Kosovë deri të shtunën e kësaj jave dhe, sipas programit operativ, do të realizohen nga ta edhe pesë operime kardiokirurgjike dhe shtatë deri në dhjetë intervenime kardiologjike.



Buxheti për FSK-në për vitin e ardhshëm pritet të jetë 123 milionë euro



PRISHTINË, 16 NËNTOR - Buxheti për Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK) për vitin e ardhshëm pritet të jetë 123 milionë euro. Ish-komandanti i FSK-së, Kadri Kastrati, ka theksuar se këto mjete duhet të shpenzohen për blerjen e mjeteve ushtarake si dhe për kapacitete njerëzore. Kastrati për "Radio Kosovën" ka thënë se situata e sigurisë në Ballkanin Perëndimor ka ndryshuar. Prandaj, edhe buxheti prej 123 milionë eurosh nuk mjafton për blerjen e armatimit.

Qeveria e Kosovës ka miratuar Projektligjin për Buxhetin e vitit 2023, i cili pritet të jetë 3 miliardë e 212 milionë euro. Nga ky buxhet, 123 milionë janë ndarë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ministrinë e Mbrojtjes.

Ish-udhëheqësi i FSK-së, gjeneral Kadri Kastrati, ka thënë se këto para nuk mjaftojnë për blerje të armatimit duke pasur parasysh ngritjen e çmimeve të çelikut dhe materialeve të tjera që përdoren për prodhimin e armëve. "Mendoj që këto para nuk janë të mjaftueshme. E tash

qeveria duhet të mendojë edhe për forcat ajrore siç janë helikopterët. Duhet të mendojë edhe për pajisjet e tjera individuale dhe kolektive që janë shumë të kushtueshme. Edhe ato armë që ka tani FSK-ja janë të vjetruara. Mendoj se qeveria do të duhej t'i ndajë mbi 200 milionë euro ose të rrisë 1.7 për qind bruto produktin vendor", ka deklaruar ai.

Deputeti i Kuvendit të Kosovës, njëherësh edhe anëtar i Komisionit Parlamentar për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes,

Hisen Berisha, ka theksuar se blerja e armatimit, trajnimet, shkollimet dhe planifikimet e tjera të furnizimit dhe e gjithë struktura brenda forcës janë në planin gjithëpërfshirës. "Nëse flitet tash për blerje armatimesh e për kalim dhe tejkalim të projektit dhe planit atëherë është joreale, ai plan mund të ndryshohet vetëm me ndihmën teknike të ShBA-së", ka thënë ai. Ndërkaq deputeti Enver Dugolli thotë se buxheti i tanishëm prej 123 milionë eurosh që, sipas planit gjithëpërfshirës të

tranzicionit të FSK-së, do të duhej të arrihet në vitin 2028. "Kemi arritur shumë në këtë fazë dhe besoj se kjo do ta përshpejtojë procesin e kompletimit të pajisjeve, trajnimeve, blerjeve ushtarake, infrastrukturën, akomodimin dhe kompletimin sa më të shpejtë të planit gjithëpërfshirës të tranzicionit", ka theksuar ai.

Me qëllim që t'i ndihmohet FSK-së, në mars të këtij viti qeveria formoi Fondin e Sigurisë, në të cilin qytetarët mund të kontribuojnë me të holla.

Ish-këshilltari i Thaçit: Tash e dy vjet Osmani e Kurti kanë suspenduar politikën e jashtme

PRISHTINË, 16 NËNTOR - Ish-këshilltari i ish-presidentit Hashim Thaçi, Artan Behrami, ka thënë se tash e dy vjet presidentja Osmani dhe kryeministri Kurti kanë

suspenduar politikën e jashtme. Sipas tij, dëmet që ka shkaktuar ministrja e Jashtme, Donika Gërvalla Schwarz, janë pothuajse të pariparueshme. "Çdo ditë e

saj në MPJ është çdo ditë disfatë për Kosovën. Është çdo ditë fitore për kundërshtarët tanë!", ka shkruar Behrami në "Facebook".



PDK-ja: Projektbuxheti i vitit 2023, buxhet i varfërisë dhe jozhvillimor

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 16 NËNTOR - Koordinator i Departamentit për Financa në Kabinetin për Qeverisje të Mirë, Arben Mustafa, ka kritikuar qeverinë për mungesë vizioni në hartimin e projektbuxhetit për vitin 2023. Mustafa, në një konferencë për medie, ka theksuar se ky projektbuxhet nuk i reflekton kërkesat e qytetarëve të Kosovës në ekonomi, krijim të vendeve të punës dhe ngritje të kualitetit të jetës. “Ky buxhet më së shumti mund të quhet një kopje e dobët e vitit 2022, sepse në shumicën e rasteve është një përsëritje e vitit 2022. Këtij buxheti i mungon ambicia zhvillimore, i mungon orientimi se ku do të jetë Kosova në fund të vitit 2023, se çfarë Kosove do të kemi në fund të vitit 2023”, ka theksuar ai.

Mustafa ka shtuar se projektbuxheti i propozuar në asnjë mënyrë nuk reflekton një strategji të karakterit zhvillimor për vendin, por kryesisht është i bazuar në shpenzime sot për sot, të cilat nuk krijojnë kushte për zhvillim afatgjatë. “Kjo qeveri assesi nuk po mund të dalë me një vizion konkret që tregon se ku synon ta çojë vendin në vitet e mbetura të mandatit të saj. Nga ajo që po shihet, kjo qeveri do të mbahet mend vetëm për



shpenzime enorme për nisma të pamenduara mirë, me efekte shumë afatshkurtra, të cilat nuk do të lënë gjurmë në rritjen afatgjatë të mirëqenies së qytetarëve të Kosovës”, ka thënë ai.

Sipas Mustafës, buxheti i këtij viti po rezulton më i lartë në krahasim me vitet paraprake kryesisht për shkak të rritjes së çmimeve në ekonomi dhe jo për shkak të rritjes së aktivitetit ekonomik. “Raporti i projektbuxhetit ka paraparë një

rritje ekonomike prej 5.5-përqindësh për vitin 2023, që paraqet pothuajse dyfishim të normës së rritjes ekonomike nga viti aktual e që nuk përkon me parashikimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore si institucionet më kredibile e të cilat sugjerojnë se rritja ekonomike në vitin 2023 nuk pritet të jetë më e lartë se rreth 3 për qind”, shtoi ai.

Mustafa nënvizoi se parashikimet e fryra të rritjes ekonomike në këto kushte të

brishta janë një rrezik i lartë për qytetarin dhe Kosovën. “Shembull konkret e kemi vitin 2022, kur kjo qeveri me fjalë shumë të mëdha kishte prezantuar shifrën e buxhetuar të investimeve kapitale prej 700 milionë eurosh, ndërsa tashmë kur ka kaluar pjesa më e madhe e vitit 2022, investimet kapitale të realizuara nuk rezultojnë të jenë më të larta se 200 milionë euro. Prandaj, në vend të numrave dhe fjalëve të mëdha, qeveria e vendit duhet të tregojë se si synon t’i

përmirësojë kapacitetet e saj për t’i realizuar ato investime që i ka paraparë në buxhet”, ka thënë ai. Mustafa konsideron se Kosova do të ketë një vit të humbur, sepse qeverisë po i nevojiten dy vjet për t’i kryer punët që do të duhej përfunduar brenda një viti. Ai ka thënë se Partia Demokratike e Kosovës në vazhdimësi ka kërkuar që qeveria t’u dalë në ndihmë qytetarëve për ta përballuar krizën e rritjes së çmimeve. “Zgjidhja më e qëndrueshme dhe më e drejtë në këto kushte do të ishte rritja e pagave, pensione dhe ndihmave sociale për të paktën aq sa është rritur niveli i përgjithshëm i çmimeve. Mirëpo duket që qeveria ka vendosur ta refuzojë këtë ide edhe për vitin 2023, duke qenë se nuk ka planifikuar buxhet që do të mundësonte një rritje të tillë. Me këtë, qeveria ose ka vendosur të pajtohet me varfërimin e qytetarëve nga rritja e çmimeve ose, ndoshta, po planifikon ta vazhdojë praktikën e pakove të njëhershme të ndihmave për kategori të caktuara të qytetarëve, të cilat nuk janë treguar efektive në adresimin e nevojave të tyre”, ka thënë Mustafa, duke shtuar se praktika e ndërmarrjes së masave ekonomike nga qeveria Kurti për ta tentuar uljen e pakënaqësive sociale do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2023.

BQK-ja: Norma mesatare e inflacionit më 2023 pritet të bie në 6.2 për qind

PRISHTINË, 16 NËNTOR - Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka njoftuar se, sipas projeksioneve të saj, norma mesatare e inflacionit për vitin 2022 në Kosovë pritet të jetë 11.6 për qind, ndërsa pritet të bie në 6.2 për qind gjatë vitit 2023. “Sipas zhvillimeve të deritanishme dhe nëse nuk paraqiten pengesa shtesë në zinxhirët e furnizimit dhe dinamikat e tregtisë globale dhe çmimeve në tregjet ndërkombëtare, inflacioni në Kosovë pritet të arrijë 13.5 për qind gjatë TM3 2022 dhe të bie në 12.3 për qind gjatë TM4 2022”, thuhet në raportin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për “Vlerësimin tremujor të ekonomisë”.

Pritjet e bankave për inflacionin, sipas raportit, tregojnë trend rritës përgjatë vitit 2022, mirëpo i cili mbetet nën nivelin e projektuar nga BQK-ja dhe nën nivelin aktual të inflacionit deri më tani. “Për ta zbutur ndikimin e inflacionit në ekonomi, qeveria ka ndërmarrë disa masa, ndër të cilat përfshihet vendosja e çmimeve tavan për derivatet (naftë, benzinë dhe gaz) nga qershori, si dhe aprovimi i pakos për përballje me inflacion në



vlerë prej 150 milionë eurosh që parashihet t’i subvencionojë faturat e energjisë elektrike sipas kriterëve që stimulojnë kursimin e energjisë, rritjen e pagave në sektorin privat, si dhe rritje të njëhershme të skemave sociale dhe pensionale dhe mbështetje financiare të njëhershme për kategori të ndryshme”, thuhet në raportin e BQK-së.

BQK-ja ka njoftuar se buxheti i Kosovës ka shënuar suficit primar buxhetor prej 58.4 milionë eurosh në TM2 2022 si rezultat i rritjes më të lartë të hyrave buxhetore krahasuar me shpenzimet, ndërkohë që borxhi publik ka rënë në 20.8 për qind të BPV-së. Sipas raportit, të hyrat buxhetore gjatë TM2 2022 arritën vlerën neto 587.6 milionë

euro (11.4 për qind rritje), përderisa shpenzimet buxhetore arritën vlerën 529.2 milionë euro (10.1 për qind rritje) dhe rrjedhimisht, buxheti i Kosovës regjistroi bilanc primar buxhetor prej 58.4 milionë eurosh gjatë këtij tremujori.

Sistemi financiar, sipas BQK-së, është karakterizuar me qëndrueshmëri dhe pa ndonjë

rrezik të materializuar gjatë TM2 2022 pavarësisht prej shqetësimeve rreth ngadalësimit ekonomik, presioneve inflacioniste dhe pasigurive të rritura në tregjet ndërkombëtare. “Sektori bankar ka arritur të sigurojë nivel të lartë të kapitalizmit dhe likuiditetit si dhe të mbajë nivel të ulët të kredive joperformuese ndër vite, gjë që rezulton të jetë përkthyer në rritje të kapacitetit absorbues të sektorit. Përderisa ekspozimi i drejtpërdrejtë i sektorit bankar në vend ndaj luftës në Ukrainë është mjaft i kufizuar, rreziqet nga zhvillimet jo të favorshme geopolitike, makroekonomike e financiare vlerësohet të jenë transmetuar kryesisht në mënyrë indirekte përmes presionit në nivelin e çmimeve”, thuhet në raportin e BQK-së.

Edhe sektori i sigurimeve rezulton ta ketë ruajtur nivelin e rritjes së aktivitetit të një viti më parë, favorizuar nga niveli më i lartë i primeve të arkëtuara dhe rritjes më të ngadalësuar të dëmeve të paguara. Sipas BQK-së, sektori ka operuar me fitim, duke ndikuar në zvogëlim të mëtejshëm të humbjeve të akumuluar ndër vite.

Dramaturgu Kristo Floqi për tezat e Cvijiqit për Kosovën si “Serbi e Vjetër”



KRISTO FLOQI

Nga: Haqif MULLIQI

“Kosova ka qenë e akuzuar për qëndrime reaksionare karshi luftës së jugut (të Shqipërisë – plot. i H.M.)”, shkruan Ali Roka, për të shtuar se artikulli i tij, në fakt tregon se qëndrimi i Kosovës ndaj kësaj lufte ishte i kushtëzuar nga shumë faktorë. Ky artikull shkruhet, i cili me qëndrimin e tij e zgjoi interesimin e studimit tek britanikët, thekson ndër të tjerat se vetë politika e ndjekur nga partizanët ishte një ndër faktorët që ka ndikuar në qëndrimet e kosovarëve, pasi që, ata, pra partizanët, kishin për qëllim zhdukjen ose shfarosjen e Kosovës dhe kthimin e dominimit serb. “Kosovarët kanë vuajtur më shumë se ç’mund të paramendohet”, shkruan Roka, “Ata ua shtrinë duart fqinjëve të vetë, por këta i qëlluan, ndaj dhe është shumë i natyrshëm reagimi i tyre”, shkruan Roka për të shtuar se, po ta vinte në sprovë jugu vëllazërinë kosovare, ata do të befasheshin se çka mund të bënin kosovarët për ta. Në vazhdim të këtij artikulli do të sjellim një shkrim jashtëzakonisht interesant të komediografit të shquar shqiptar Kristo Floqit, gjegjësisht një polemikë e tija me tezat e Jovan Cvijiqit, profesorit hegjemonist të Universitetit të Beogradit i cili ndërtoi me dhjetëra dhe dhjetëra teza dhe doktrina të rrejshme mbi atë se si Kosova është “djep i Serbisë”, apo edhe

“Serbi e Vjetër”.

Ja se si fillon ky shkrim i Floqit, që është i radhitur si artikulli “M” i dosjes britanike të Foreign Office-it, që mban titullin: A është Kosova Serbi e Vjetër?

“Serbët dhe kroatët e pushtuan Ballkanin e me këtë edhe Shqipërinë rreth vitit 640 të erës sonë”, shkruan ky autor. Ata erdhën në Kosovë e cila ishte e banuar nga shqiptarët, pjesëtar të fisit dardan. Gjatë historisë, ky territor u sundua nga serbët dhe nga shqiptarët, por elementi shqiptar ishte original (vendas), ndërsa elementi sllav, siç e dëshmon edhe vetë historia, erdhi më vonë”, shkruan Floqi.

“Emri ‘Serbi e vjetër’, shton ky autor, “është i trilluar nga prof. Cvijiqi dhe nuk haset në asnjë vepër përveçse në veprën e tij. Historiani tjetër serb, Vuk Karaxhiq, i cili ka udhëtuar nëpër Kosovë dhe i cili kishte njohuri të dorës së parë për këtë vend dhe këtë popull, këtë vend e quan Kosovë e jo Serbi e Vjetër”, konstaton Floqi.

“Një shkrimtar tjetër, bullgar, Dr. Ichirkoff (emri mund të jetë i pasaktë pasi që në dokument është shkruar në anglisht e jo sipas originalit – vr. E.H.M.), në veprën e tij ‘Etudde ethnologichues sur les slavs de Macédonie’, këtë vend e quan Kosovë e jo Serbi e Vjetër’. Pas luftës ruso-turke, më 1878, u revizuan kufijtë e Gadishullit Ballkanik, mirëpo asgjëkund nuk haset termi Serbi e Vjetër, i aplikuar për Kosovën, por vetëm emërtimi

Kosovë”.

“Edhe hartat e Kiepertit asnjëherë nuk e kanë përdorur termin Serbi e Vjetër, kur flitet për Kosovën. Në të gjitha statistikat e mbajtura nga Perandoria Otomane”, thekson Floqi, “është përdorur emri Kosovë për këtë regjion. Në të gjitha korrespondencat e ambasadorëve të huaj përdoret vetëm emri Kosovë, jo Serbi e Vjetër. Në të gjitha gjeografit e vjetra serbe, ekskluzivisht përdoret emri Kosovë, ndërsa atë Serbi e Vjetër nuk e hasim asnjëherë. Në veprën e G. Verdenit (diplomat francez) për Maqedoninë, kurrë nuk është përdorur emri Serbi e Vjetër, por gjithnjë është përdorur Kosovë. Në fjalorin e madh historiko-gjeografik të Ahmet Rifat Pashës (Grand Dictionnaire Historique e Geographique -1884), asnjëherë nuk haset termi Serbi e Vjetër, por vetëm Kosova. Në koleksionin e hartave të quajtura ‘Nona Europae Tabula e Decima Europae Tabula’, të botuar në Romë më 1940, botuar në veprën e Ptolemit, termi Serbi e Vjetër nuk përdoret asnjëherë kur flitet për këtë territor, por vetëm termi Kosova. Kjo që vijon është lista e hartave të cilat dëshmojnë se Kosova, gjithmonë është quajtur Kosovë e kurrë ‘Serbi e vjetër’, dhe se Kosova ka qenë gjithmonë shqiptare:

1. *Theatrum orbis terrarum sive atlas noveus parvo tertia, nga Guillaume dhe F. Blaeu, Amsterdam 1650.*

2. *Mercuric geographico, nga G.*

Rossi, Romë 1674

3. *Troisième partie de la carte d’Europe, Auville 1760*

4. *Nuovo atlante geographico universale, Causini 1792*

5. *European Domination of the Ottoman or Turkey in Europe nga W.Fadeni, Londër 1795*

6. *Karte von dem Osmanischen Reiches in Europa, nga Franz von Kelly, Vienë 1769*

7. *Imperii Osmani sive turcici Europae Tabula ad norman recentissimarum observationum conciuata Samitibus, botuar nga John Walka, 1979*

8. *The European Map, nga A. Arroësmith, Londër*

9. *Care de la Turquie en Europe en 15 feuilles, nga p. G. Chaulaire, 1800*

10. *Atlanto Veneto, 1694*

Përveç kësaj, Pjetër Bogdani, arqipeshkvi i Shkupit, në një letër të shkruar më 10 shkurt 1675, përmend këtë territor duke e quajtur Kosovë, jo Serbi e Vjetër.

Dy shkrimtarët serb, V. Karaxhiq dhe Ivan Raiq kurrë nuk e quajtën këtë territor Serbi e Vjetër në veprat e tyre (ata kanë shkruar më 1887 dhe 1794). Bile, edhe Vladimir Ivanoviç, një përkrahësi i flaktë i pansllavizmit në Ballkan, në librin e tij ‘Les Sebes et la mission l’Europe de la serbie fans Europe d’Orient’, Bosnjën dhe Hercegovinën e quan Serbi e vjetër, kurse Kosovën e konsideron Shqipëri. Këtë e konfirmon edhe bashkëvendësi i tij Dimitrije Stefanoviç, shkruan Kristo Floqi në studimin e tij mjaft informativ dhe kurioz për

britaniket.

“Edhe Pougueville”, shkruan më tej Floqi, “ambasadori francez te Ali Pasha i Janinës, në veprën e tij ‘Voyage en Moree, a Constantinopole, et en Albanie 1865’, por edhe Boue, shkrimtari francez, në librin e tij ‘Redull d’itinéraires fans la Turquie d’Europe 1884’, pohojnë se Kosova është plotësisht shqiptare dhe kurrë nuk e quajtën atë Serbi e Vjetër. Të gjithë këto argumente të dokumentuara që dëshmojnë se Kosova është shqiptare janë prova të mjaftueshme për të kënaqur edhe studentin më skeptik dhe më kritik të historisë”, shkruan Floqi. “Është e evidente”, shton ky autor, “lakmia për pasurinë e te tjerëve në veprën e prof. Cvijiqit, lakmi e cila e udhëheq gjykimin e tij, gjer në atë masë, sa që e bënë atë të verbër dhe qesharak. Shumë truce kanë përdorur serbët për të marr Kosovën dhe për të çrrënjësuar elementin shqiptar, por, fakti se këtë nuk e arritën është një argument me shumë që shpie drejt të konkluduarit e vërtetë se Kosova ka qenë dhe është shqiptare. ‘Dashuria e ujkut të vjetër ndaj qengjit’, shtrembëron madje edhe të vërtetën më evidente historike duke e turpëruar historinë dhe pasionin e shkencëtarit për objektivitet, duke përdorur terma të tillë të shëmtuar siç është ai Serbi e Vjetër”, përfundon komediografi i shquar shqiptar, Kristo Floqi, në polemikën e tij me shkencëtarin serbe Jovan Cvijiqi rreth emërimit të vërtetë të Kosovës.

Mbappe shihet si zëvendësues i Ronaldos

MANCHESTER, 16 NËNTOR - Manchester United dhe Cristiano Ronaldo janë një hap larg "divorcit". Intervista e pesë herë fituesit të "Topit të Artë" me gazetarin anglez, Piers Morgan, ka krisur çdo

marrëdhënie mes "Djajve të Kuq" dhe yllit portugez. Sipas asaj që raporton britanikja "Mirror", drejtuesit e Unitedit kanë evidentuar pasuesin ideal të Ronaldos, i cili është Kylian Mbappe. Në Angli janë

të sigurt që Mbappe do t'u thotë lamtumirë parisienëve që në muajin janar dhe Unitedi ka gati ofertën prej 150 milionë eurosh për ta bërë për vete sulmuesin francez. Nëse tratativa në mes të

Mbappesë dhe Unitedit dështon, atëherë klubi nga Manchester United ka gati opsionin B, që është Viktor Osimhen, i cili po kalon një moment fantastik në karrierë me Napolin.



Anglia me skuadrën më të vlefshme në 'Katari 2022'

LONDËR, 16 NËNTOR - Në Kampionatin Botëror do të marrin pjesë disa prej futbollistëve më të mirë në botë. Spektakli do të shfaqë talentet më të mirë të futbollit që luajnë në ligat më prestigjioze, duke përfshirë Ligën Premier, Serinë A, La Ligën dhe Ligën I. Lojtarët e Francës ngritën trofeun e Kupës së Botës në vitin 2018, duke fituar kundër Kroacisë në stadiumin "Luzhniki" në Rusi. Me 32 përfaqësues që marrin pjesë në garë, disa skuadra natyrisht se do ta kenë vlerën më të madhe prej të tjerash. Sipas "Marca"-s, Anglia do të shkojë në Katar me ekipin më të vlefshme në botë. Të dhënat mbi vlerën e tregut të lojtarëve të mbledhura nga "Transfermarkt" tregojnë se "Tre Luanët" kanë lojtarë të shumtë të vlerësuar në 80 milionë euro ose më shumë. Asi i Tottenham Hotspurit, Harry Kane, Phil Foden dhe Bukayo Saka janë disa nga lojtarët më të vlefshëm



Lista e dhjetë përfaqësuesve më të shtrenjta në Kampionatin Botëror:

Anglia - 1.35 miliard euro
Franca - 1.13 miliard euro
Brazili - 1.064 miliard euro
Spanja - 1.031 miliard euro
Gjermania - 1.025 miliard euro

Portugalia - 938 milionë euro
Argjentina - 764 milionë euro
Belgjika - 55 milionë euro
Holanda - 474 milionë euro
Uruguai - 419 milionë euro.

të Anglisë. Franca është skuadra tjetër që shkon në Kupën e Botës me një ekip të shtrenjtë, me skuadrën që përmban disa prej talenteve më të mirë në botë.

Clippersat mposhten nga Dallasi, tjetër dështim për Brooklynin

Dallas, 16 nëntor - Tjetër zhgënjim për skuadrën e Brooklynit, që u mund me rezultat 153-121 nga Sacramento, që nga ana e tij korri fitoren e katërt radhazi. Kevin Durant me 27 pikë e pati të pamundur ta mbajë skuadrën në lojë, ndërsa për Sacramento u dallua Davisi me 31 pikë edhe pse e nisi ndeshjen nga stoli. Fitore në sekondat e fundit arriti skuadra e Dallasit, që mundi me shifrat 103-101 clippersat, në një sfidë me rivalitet. George me 23 pikë e Batumi me 22 pikë nuk



arritën ta evitojnë humbjen për kalifornianët, ndërsa për Dallasin u dallua Luka Dončić, autor i 35 pikëve e 11 reboundeve. Humbja e tretë radhazi për Utah Jazzin, që u mund nga New York (118-11), sfidë ku u dallua Brunsoni me 25 pikë.

Fiton edhe Portlandi, që falë 29 pikëve të Grantit mundi me rezultat 117-110 San Antonion, ndërsa New Orleansi mposhti 113-102 Memphisin, ndeshje ku dallimin e bëri Ja Morant, autor i 36 pikëve.

REZULTATET

New Orleans - Memphis	113-102
Dallas - Clippers	103-101
Utah Jazz - New York	111-118
Portland - San Antonio	117-110
Sacramento - Brooklyn	153-121

Hamilton: Botërori i kaluar u manipulua në garën e fundit

Këtë fundjavë do të zhvillohet në pistën e Yas Marina gara e fundit sezonale e Botërorit të Formula 1. Një pistë ku vitin e kaluar u vendos fati i titullit kampion për pilotë, me Max Verstappenin që parakaloi Lewis Hamiltonin në xhiron e

fundit mes shumë polemikave pas vendimeve të komisarëve të garës. Piloti britanik, shtatë herë kampion bote, nuk e ka harruar atë ditë të mallkuar për të, ku iu hoq fitorja nga duart pak kilometra nga finishi. "Botërori i kaluar ishte i

manipuluar. Dikush vendosi që kampion bote duhej të ishte Max Verstappen dhe ashtu ndodhi në pistë", u shpreh Hamiltoni nga Abu Dhabi. Duke bërë një krahasim mes titullit të fituar prej tij në vitin 2008, në Brazil, kur Toyota e

Timo Glock vendosi gjithçka në dëm të Felipe Massa. "Ai botëror nuk u manipulua. Ato dy ngjarje nuk mund të krahasohen edhe pse në të dyja rastet titulli u vendos në xhiron e fundit, ku njëri pilot u zhgënjye. Botërori 2008 nuk u

manipulua, ndërsa ai vjet po. Vjet titulli u vendos nga të tjerët, nga komisarët e garës, që morën vendime absurde dhe kundër rregullores në xhiron e fundit. Ndaj them se vjet titulli u manipulua", ka shtuar Hamiltoni.

SHKURT

Nkunku s'do të luajë në Kupën e Botës

Sulmuesi i Leipzigut, Christopher Nkunku, nuk do të luajë në Kupën e Botës "Katar 2022". Ai pësoi një lëndim në stërvitje në duelin me Eduardo Camavingan. Kombëtarja franceze ka njoftuar zyrtarisht këtë të martë se Nkunku mbetet jashtë Kupës së Botës, që fillon më 20 nëntor. "I lënduar në stërvitje, Christopher Nkunku largohet nga Kupa e Botës. I gjithë grupi ndan trishtimin e Christopherit dhe i uron atij shërim të shpejtë", thuhet në njoftim.

Danilo: Franca dhe Argjentina janë shumë të forta

Futbollisti i Brazilit, Danilo, ka vlerësuar se Franca dhe Argjentina janë shumë të forta dhe mund të shkojnë shumë larg në Kupën e Botës 2022. "Franca dhe Argjentina janë shumë të forta dhe do të shkojnë shumë larg, por ne kemi lojtarë të rëndësishëm që luajnë në skuadrat më të mëdha në botë", ka thënë Danilo për parashikimin e tij në prag të Kupës së Botës. "Kur futemi në fushë me fanellën e kombëtares kemi gjithmonë ndjenjën se jemi ata djem që në Brazil ëndërronin të dilnin në fushë dhe ta fitonin Kupën e Botës dhe më pas ta përfaqonin familjen me kupën në dorë. Ne e kemi këtë ndjesi, na jep një forcë që nuk mund të imagjinohet", është shprehur anësori i Juventusit dhe i Brazilit.

Messi do t'i bashkohet Barçës vetëm nëse Xavi është trajner

Kushti i vetëm i yllit të PSG-së, Lionel Messit, për t'u rikthyer në ish-klubin e tij, Barcelonë, sezonin e ardhshëm, është që Xavi Hernandez të mbetet trajner i klubit, njofton "El Nacional". Raportohet se dy ish-bashkëlojtarët kanë qenë në komunikim të vazhdueshëm me njëri-tjetrin dhe Messi do të luajë te Barça vetëm nën drejtimin e Xavit. Ish-mesfushori ka pasur një fillim të mirë të sezonit në La Ligë, me skuadrën e tij në krye të tabelës që shkon në pushimin e Kupës së Botës. Megjithatë, eliminimi i hershëm nga Liga e Kampionëve e ka vënë atë nën presion. Presidenti i Barcelonës, Joan Laporta, do të duhet ta mbajë Xavin pavarësisht se si përfundon sezoni nëse dëshiron ta shohë përsëri Messin në "Camp Nou".

Pensionohet Cahill

Një nga mbrojtësit më të mirë anglezë që ka luajtur te Chelsea në dekadën e fundit, Gary Cahill, është pensionuar nga futbolli. Mbrojtësi Cahill ka njoftuar se i ka dhënë fund angazhimit të tij si futbollist aktiv. Cahill numëron në sirtarin e tij dy tituj në Premierligë, dy Kupa FA, dy Liga të Evropës dhe një Ligë të Kampionëve si dhe një Kupë të Ligës. Gjatë karrierës së tij, lojtari numëroi 61 paraqitje me kombëtaren e Anglisë.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 5, 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 03/2021 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit (shpallur në Gazetën Zyrtare më 16.09.2021); lidhur me nenin 26.4 dhe 27.2 të Rregullores (ZKA) 02/2021 për Klasifikimin e Vendeve të Punës; Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2022 (i ndryshuar/plotësuar), si dhe Vendimit të Auditorit të Përgjithshëm me Nr. 2326 të datës 11.11.2022 për plotësimin e vendeve të lira të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit shpall:

KONKURS

për plotësimin e vendeve të lira të punës

1. Pozita:	Auditor junior për auditim financiar dhe pajtueshmëri
Numri i referencës:	AJAFP/ZKA/23-11/22
Grada:	ZKA-A8
Numri i pozitave:	Dy (2)
Kohëzgjatja e emërimit:	Me kohë të pacaktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ndihmon UE në mbledhjen e informatave paraprake për auditimet ku angazhohet, për përgatitjen e dosjeve të auditimit dhe punë tjera në lidhje me auditimin;
- Shkrimi i letrave të punës së auditimit të qarta për çështjet e trajtuara dhe sipas standardeve të ZKA-së dhe të njëjtat i dorëzon me kohë të UE;
- Indeksi i letrave të punës për temat (mostrat) dhe fushat e audituara dhe të gjitha dokumentet (edhe ato që merren në Entitete) duhet të jenë në pajtueshmëri me formatin dhe kërkesat e përcaktuar nga metodologjia, që t'i mundësoj UE një rishikim me të lehtë;
- Përfundimi me kohë i letrave të punës, memove të komponentëve dhe të gjitha detyrave sipas kërkesave të UE për t'i arritur planet kohore të aprovuar nga menaxhmenti;
- Ofron bashkëpunim dhe informata të sakta për Ekipin e auditimit, departamentin e tij dhe me të gjithë sektorët dhe departamentet e tjerë në kuadër të ZKA-së;
- Ndihmon stafin tjetër të ekipit dhe të departamentit, rreth punëve audituese, për përdorim të teknologjisë informative, ofron përkrahje UE dhe të jetë përgjegjës në ushtrimin e detyrave për realizimin e objektivave të ekipit dhe të departamentit;
- Komunikim të mirë me anëtarët e ekipit me UE, DD, stafin e ZKA dhe me stafin e entiteteve gjatë auditimit;
- Të ruajë dhe azhurnoj njohuritë profesionale dhe teknike dhe të tregoj gatishmëri për të marrë njohuri të reja nga fusha e auditimit për fushat e dakorduara me UE dhe DD gjatë vlerësimit të performancës për vitin e kaluar, dhe të ndjekë trajnimet e organizuara nga ZKA që lidhen me Edukimin e Vazhdueshëm Profesional;
- Tregon integritet të lartë dhe vepron në pajtim me Kodin Etik dhe të Mirësjelljes Profesionale, si brenda ashtu edhe jashtë ZKA-së;
- Kryen edhe detyra tjera profesionale që mund të kërkojnë nga UE dhe DD i/e tij.

Kualifikimet themelore:

- Diplomë fakulteti;
- Tre (3) vite përvojë pune profesionale në auditim, kontabilitet, financa ose administratë publike;
- Certifikatë në njërin nga skemat e certifikimit si teknik kontabiliteti dhe asistent-auditor i sektorit publik.

Shkathësitë e kërkuara:

- Njohuri në fushën e auditimeve;
- Shkathësi në organizim të punës dhe përbushje të objektivave;
- Njohuri të akteve juridike të aplikueshme në Zyrën Kombëtare të Auditimit;
- Njohuri për mbikëqyrje efektive të punës profesionale;
- Aftësi për të përfaqësuar dhe mbrojtur interesat e institucionit dhe integritetin e tij;
- Aftësi motivuese, dhe komunikuese në ekip;
- Të posedoj aftësi të mira ndër-personale.

2. Pozita:	Auditor për teknologji të informacionit
Numri i referencës:	ATI/ZKA/24-11/22
Grada:	ZKA-A7
Numri i pozitave:	Një (1)
Kohëzgjatja e emërimit:	Me kohë të pacaktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kryen auditime të sistemeve të informacionit në koordinim me UE, sipas planit vjetor, rregullave dhe metodologjisë së ZKA-së, Kodit të Etikës dhe në pajtim me Standardet Ndërkombëtare dhe i raporton udhëheqësit të ekipit dhe Drejtorit të Departamentit të Auditimit;
- Ndihmon Udhëheqësin e ekipit dhe koordinohet rreth procesit auditues si dhe komunikon/konsultohet rregullisht me UE dhe Drejtorin e Departamentit dhe raporton për arritjen e objektivave sipas planit të aprovuar nga Drejtori i departamentit;

- Kryen hulumtime dhe analizë në fushën e sistemeve të informacionit në sektorin publik dhe bën propozimin e temave audituese për planifikimin strategjik dhe atë vjetor të ZKA-së;
- Merrë pjesë aktive në planifikim/parastudim dhe kryen vlerësimin e rreziqeve për sistemet e informacionit të audituara/monitoruara sipas fushave të përcaktuara nga UE dhe pjesëmarrje në përcaktimin e objektivave, fushës audituese si dhe kritereve dhe metodave të auditimit;
- Komunikon mirë brenda ekipit dhe me entitet, kryen detyrat e përcaktuara nga UE dhe koordinohet në fazat e procesit auditues (planifikim, ekzekutim dhe raportim) dhe merrë pjesë aktive në takime, intervista dhe diskutime me entitetin;
- Kryen hulumtime dhe analiza të sistemeve dhe të të dhënave dhe siguron dokumentimin e tyre si dhe shkrimin e gjetjeve duke përfshirë elementet-kriterin, gjendjen, shkakun dhe efektin/rrezikun. Siguron dëshmi të mjaftueshme duke nxjerrë përfundime/konkluzione të bazuara dhe dhënien e rekomandimeve;
- Përgatitë Letrat e Punës dhe Memo përmbledhëse lidhur me auditimin e fushës/komponentës audituese të përcaktuar nga udhëheqësi. Krijon dosjen/dëshmitë e auditimit dhe bënë indeksimin e tyre sipas kërkesave të UE dhe rregullave të ZKA;
- Ofron mbështetje për UE në hartimin e Draft raportit dhe në proceset e rishikimit (zbatimin e komentëve), në finalizimin e raportit të auditimit dhe aktivitetet pas raportuese si dhe merrë pjesë në prezantime dhe seminare ndërlidhur me atë raport;
- Ofron përkrahje dhe bashkëpunim nëse kërkohet në nivel të ZKA-së, në mënyrë që të ofroj mbështetje dhe duhur lidhur me sistemet e TI për fushat që auditohen nga stafi tjetër i zyrës (për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë) si dhe kontribuon në RVA;
- Siguron se aktivitetet audituese kryhen në pajtim me kërkesat e ZKA përfshirë punën e organizuar online/nga shtëpia, zbaton manualët e auditimit dhe siguron se përdoren sistemet e vendosura për auditim në ZKA dhe sistemet e veçanta për auditimet e SI-së;
- Ruan dhe azhurnon njohuritë profesionale dhe teknike përmes trajnimeve dhe Edukimit të Vazhdueshëm Profesional si dhe tregon gatishmëri për të zhvilluar vetveten në fushat e dakorduara me Drejtorin gjatë vlerësimit të performancës;
- Kryen edhe detyra të tjera profesionale të kërkuara nga UE dhe nga Drejtori i departamentit.

Kualifikimet Themelore:

- Diplomë fakulteti në fushat relevante të TI-së;
- Tre (3) vite përvojë pune profesionale në fushën e TI-së, preferohet përvojë pune në fushën e auditimit;
- Preferohet certifikim për auditor nga fusha e TI-së;
- Preferohet njohuri e gjuhës angleze.

Shkathësitë e kërkuara:

- Njohuri të theksuara në fushën e auditimeve;
- Shkathësi në organizim të punës dhe përbushje të objektivave;
- Njohuri të akteve juridike të aplikueshme në Zyrën Kombëtare të Auditimit;
- Njohuri për mbikëqyrje efektive të punës profesionale;
- Aftësi për të përfaqësuar dhe mbrojtur interesat e institucionit dhe integritetin e tij;
- Aftësi motivuese, dhe komunikuese në ekip;
- Të posedoj aftësi të mira ndër-personale.

Informata të përgjithshme për kandidatë:

Kompensimi i pagës për pozitat e shpallura bëhet në përputhje me rregullat e brendshme të punës së Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Procedura e Aplikimit:

Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:

- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore dhe përvojën e punës;
- dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë;
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (nëse aplikohet);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen.

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (online) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit, afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data 02.12.2022 ora 16.00.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

Shënim:

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

U skladu sa Članom 15.2 Zakona Br. 05/L-055 o Generalnom revizoru i Nacionalnoj kancelariji revizije Republike Kosovo, kao i Članom 5, 6 i 7 Pravilnika (NKR) 03/2021 ZA o Prijemu i Karijeru u Nacionalnoj kancelariji revizije (objavljeno u Službenom listu 16.09.2021), vezano za Član 26.4 i 27.2 Pravilnika (NKR) 02/2021 o Klasifikaciji radnih mesta, Godišnjem planu zapošljavanja kao i Odluci Generalne revizorke sa Br. 2326 datuma 11.11.2022 o popunjavanju slobodnog radnog mesta, Nacionalna kancelarija revizije objavljuje:

KONKURS za popunjavanje slobodnih radnih mesta

1. Pozicija:	Junior Revizor za finansijsku reviziju i reviziju usklađenosti
Broj reference:	AJAFP/ZKA/23-11/22
Koeficijent:	ZKA-A8
Broj pozicija:	Dva (2)
Trajanje imenovanja:	Na neodređeno vreme

Dužnosti i odgovornosti:

- Pomaže VT-u u prikupljanju preliminarnih informacija o revizijama u kojima se angažuje, u pripremi revizorskih dosijea i obavlja druge poslove vezanih za reviziju;
- Jasno pisanje u popunjavanju revizorskih radnih dokumenata o adresiranim pitanjima u skladu sa standardima NKR-a i njihovo blagovremeno dostavljanje VT-u;
- Indeksiranje radnih dokumenata o temama (uzorcima) i revidiranim oblastima i svih dokumenata (uključujući one primljene od subjekata) koje treba da budu u skladu sa formatom i zahtevima navedenim u metodologiji, kako bi se VT-u omogućila lakša revizija;
- Blagovremeno popunjavanje radnih dokumenata, memoranduma o komponentama i svih zadataka u skladu sa zahtevima VT-a da bi se postigli rokovi koje je odobrio menadžment;
- Pruža saradnju i tačne informacije Timu za reviziju, njegovom departmanu i svim drugim sektorima i departmanima u okviru NKR-a;
- Pomaže drugom osoblju tima i departmana, oko revizorskog rada, za korišćenje informacionih tehnologija, pruža podršku VT-u i odgovoran je u sprovođenju zadatka za postizanje objekta tima i departmana;
- Dobra komunikacija sa članovima tima sa osobljem VT-em, DD-em, NKR-om i osobljem subjekata tokom revizije;
- Održavati i ažurirati stručno i tehničko znanje i pokazati spremnost za sticanje novih znanja iz oblasti revizije za oblasti dogovorene sa VT-em i DD-em tokom procene učinka za prethodnu godinu, kao i za pohađanje obuka koje organizuje NKR u vezi sa kontinuiranim profesionalnim usavršavanjem i obrazovanjem;
- Pokazuje visok integritet i poštuje Kodeks etike i profesionalnog ponašanja, kako unutar tako i van NKR-a;
- Obavlja i druge profesionalne zadatke koje se mogu zahtevati od VT-a i DD-a.

Osnovne kvalifikacije:

- Fakultetska diploma;
- Tri (3) godine profesionalnog radnog iskustva u reviziji, računovodstvu, finansijama ili javnoj upravi;
- Sertifikat u jednoj od šema sertifikacije kao računovodstveni tehničar i pomoćnik-revizor u javnom sektoru.

Potrebne veštine:

- Poznavanje polja revizije;
- Veštine u organizaciji rada i ispunjavanju ciljeva;
- Poznavanje pravnih akata koji važe za Nacionalnu kancelariju revizije;
- Poznavanje o efektivnom nadzoru profesionalnog rada;
- Veštine da predstavlja i štiti interese institucije i njenog integriteta ;
- Motivacione i komunikativne veštine u timu;
- Dobre međuljudske veštine.

2. Pozicija:	Revizor (informacione tehnologije)
Broj reference:	ATI/ZKA/24-11/22
Koeficijent:	ZKA-A7
Broj pozicija:	Jedan (1)
Trajanje imenovanja:	Na neodređeno vreme

Dužnosti i odgovornosti:

- Završava revizije sistema informacije u koordinaciji sa VT, prema godišnjem planu, pravilnicima i metodologiji NKR-a, koda etike i u skladu sa međunarodnim standardima i izveštava vođu tima i direktoru departmana revizije;
- Pomaže vođu tima i koordinira se oko procesa revizije kao i komunicira/konsultuje se redovno sa VT i direktorom departmana i izveštava o dostignućima ciljeva prema odobrenom planu od strane direktora departmana;
- Vršiti istraživanja i analize u polju sistema informacija u javnom sektoru i predlaže revizijske teme o strateškom i godišnjem planiranju NKR-a;
- Aktivno učestvuje u planiranju/pred studiji i vrši procenu rizika za revidirane/pračene informacione sisteme prema oblastima definisanim od strane VT i učešće u definisanju ciljeva, oblasti revizije kao i kriterijuma i metoda;

- Dobro komunicira unutar tima i sa subjektom, obavlja zadatke definisane od strane EU i koordinira u fazama procesa revizije (planiranje, izvršenje i izveštavanje) i aktivno učestvuje u sastancima, intervjuima i diskusijama sa subjektom;
- Vršiti istraživanje i analizu sistema i podataka i obezbeđuje njihovu dokumentaciju kao i pisanje nalaza uključujući kriterijume-elemente, stanje, uzrok i efekat/rizik. Pruža dovoljno dokaza donoseći zaključke/konkluzije osnovane u davanju preporuka;
- Pruža dovoljno dokaza tako što donosi utemeljene zaključke/konkluzije osnovane u davanju preporuka;
- Priprema radne dokumente i sažetke memoranduma koji se odnose na reviziju oblasti/komponente koju definiše vođa. Kreira revizijski fajl/dokaze i vrši njihovo indeksiranje u skladu sa zahtevima VT i pravilima NKR-a;
- Pruža podršku VT-u u izradi Nacrta izveštaja i u procesima pregleda (implementaciji komentara), u završavanju revizorskog izveštaja i aktivnosti posle izveštavanja, kao i učestvuje u prezentacijama i seminarima u vezi sa tim izveštajem;
- Pruža podršku i saradnju ako je potrebno na nivou NKR -a, kako bi se pružila odgovarajuća podrška u vezi sa IT sistemima za oblasti koje revidiraju drugo kancelarijsko osoblje (za finansijske revizije i revizije usklađenosti), kao i doprinos GIR;
- Obezbeđuje da se aktivnosti revizije sprovede u skladu sa zahtevima NKR-a, uključujući organizovani onlajn/kucni rad, implementira priručnike revizije i obezbeđuje da se koriste sistemi uspostavljeni za reviziju u NKR-u i posebni sistemi za revizije IS;
- Sačuva i ažurira stručna i tehnička znanja kroz obuke i kontinuirano stručno obrazovanje, kao i pokazuje spremnost da se razvija u oblastima dogovorenim sa direktorom tokom procene učinka;
- Obavlja i druge stručne poslove na zahtev VT i direktora departmana.

Osnovne kvalifikacije:

- Diploma fakulteta iz relevantnih IT oblasti;
- Tri (3) godine profesionalnog radnog iskustva u oblasti IT, poželjno radno iskustvo u oblasti revizije;
- poželjna sertifikacija IT revizora;
- Poželjno poznavanje engleskog jezika.

Potrebne veštine:

- Savršeno znanje u oblasti revizije;
- Veštine u organizaciji rada i ispunjenju ciljeva;
- Znanje pravnih akata važećih u Nacionalnoj kancelariji revizije;
- Znanje o efektivnom nadzoru profesionalnog rada;
- Sposobnost da bi predstavljali i branili interese institucije i njenog integriteta;
- Motivacione i komunikativne sposobnosti u timu;
- Dobre međuljudske veštine.

Opšte informacije za kandidate:

Naknada plate za objavljene položaje vrši se u skladu sa internim pravilima rada Nacionalne Kancelarije Revizije.

Procedura apliciranja:

Procedura apliciranja je otvorena za sve kandidate koji ispunjavaju kriterijume konkursa.

Nacionalna Kancelarija Revizije pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i dočekuje kandidate iz svih zajednica na Kosovu

Kandidati trebaju dostaviti sledeća potrebna dokumenta:

- službeni Formular NKR-a za apliciranje;
- kopiju lične karte Republike Kosova;
- dokaze o školskoj spremi i radnom iskustvu;
- dokaz iz suda da nije osuđivan pravnosnažnom odlukom;
- dokaz da ne postoji disciplinska mera za razrešenje sa funkcije javnog službenika (ako je primenljiva);

Samo službeni obrazac za konkurisanje će se uzimati u obzir. Formulari za konkurisanje dostavljeni nakon isteka roka se ne razmatraju a nepotpune će biti odbijene. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume.

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) dana od dana objavljivanja na elektronskim medijama (onlajn) i na internet stranici Nacionalne Kancelarije Revizije, zadnji rok za podnošenje dokumentacije 02.12.2022 godine do 16.00 časova.

Obrasci za aplikaciju mogu se preuzeti na recepciji NKR-a ili se mogu preuzeti sa veb stranice NKR-a na adresi www.zka-rks.org i dostavljaju se u Odeljenju za administriranje dokumenata Nacionalne Kancelarije Revizije na adresi: Naselje: Arbëria, ul. "Ahmet Krasniqi" br. 210 – Priština, svakog radnog dana od 08:00 – 16:00, Obrazac i prateća dokumenta se takođe mogu dostaviti e-poštom na rekrutimi@oagks.org ili preko pošte. Za detaljnije informacije možete se obratiti na br.tel. 038/606-004, ext:1025.

Beleška:

Aplikacije poslate poštom, koje imaju poštanski žig na uručanju izvršenom poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se validnim i biće uzete na razmatranje.



SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli: Zyrtar i ri për Operacione me Para të Gatshme
Departamenti: i Parave dhe Marrëdhënieve Bankare
Divizioni: i Parave të Gatshme
Niveli i gradës: 7
I raporton: Udhëheqësit të Divizionit të parave të gatshme

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Në koordinim me Udhëheqësin e Divizionit, Zyrtaret e lartë të operacioneve me para të gatshme dhe Zyrtaret e tjerë të Divizionit ndihmon në kryerjen e depozitave dhe tërheqjeve të parave të gatshme sipas planit të termineve të klientëve;
- Në koordinim me Udhëheqësin e Divizionit, Zyrtaret e lartë të operacioneve me para të gatshme dhe Zyrtaret e tjerë të Divizionit ndihmon në përgatitjen e tërheqjeve të parave të gatshme sipas planit të termineve të klientëve;
- Në koordinim me Udhëheqësin e Divizionit, Zyrtaret e lartë të operacioneve me para të gatshme dhe Zyrtaret e tjerë të Divizionit pranon depozitat e parave të gatshme nga palët;
- Në koordinim me Udhëheqësin e Divizionit, Zyrtaret e lartë të operacioneve me para të gatshme dhe zyrtaret e tjerë të Divizionit ndihmon në procesin e përgatitjes së tërheqjeve të parave të gatshme nga palët;
- Në koordinim me Udhëheqësin e Divizionit, Zyrtaret e lartë të operacioneve me para të gatshme dhe Zyrtaret e tjerë të Divizionit regjistron në sistemin e kontabilitetit transaksionet ditore me para të gatshme;
- Në koordinim me Udhëheqësin e Divizionit, Zyrtaret e lartë të operacioneve me para të gatshme dhe Zyrtaret e tjerë të Divizionit angazhohet në procesimin e parave të gatshme;
- Në koordinim me Udhëheqësin e Divizionit, Zyrtaret e lartë të operacioneve me para të gatshme dhe Zyrtaret e tjerë të Divizionit merr pjesë në hapjen dhe mbylljen e Trezorëve sipas rregullave dhe procedurave;
- Asiston Udhëheqësin e Divizionit, Zyrtaret e lartë të operacioneve me para të gatshme dhe Zyrtaret e tjerë të Divizionit gjatë procesit të reconciliimit të gjendjes së parave të gatshme në trezorë me gjendjen e kontabilitetit;
- Asiston Udhëheqësin e divizionit, Zyrtaret e lartë të operacioneve me para të gatshme dhe Zyrtaret e tjerë të Divizionit gjatë procesit të përgatitjes, transportit dhe logjistikës së parave të gatshme;
- Në koordinim me Udhëheqësin e Divizionit, Zyrtaret e lartë të operacioneve me para të gatshme dhe Zyrtaret e tjerë të Divizionit angazhohet në regjistrimet e parave të gatshme;
- Kryen punë të tjera të ndërlidhura me operacionet me para të gatshme dhe të Trezorit.

Edukimi:

- Diplomë universitare;
- Preferohet të ketë njohuri mbi veçoritë e sigurisë së kartëmonedhave dhe monedhave euro dhe njohuri mbi makinat moderne për procesim të parave të gatshme;
- Njohuri e mirë e aplikacioneve MS office dhe aplikacioneve bankare.

Përvoja e punës:

- Përvoja e punës si Trezorist, Procesues i parave të gatshme ose Arkëtar është e dëshirueshme.

Njohja e gjuhëve të huaja:

- Njohuri e shkëlqyeshme e gjuhës shqipe dhe/ose serbe;
- Njohuri e gjuhës angleze është e dëshirueshme.

Kërkesat e posaçme:

- Të mos ketë qenë asnjëherë subjekt i ndonjë veprë penale;
- Mbajtje e lartë e fshehtësisë;
- Vëmendje në detaje dhe saktësi;
- Aftësi të shkëlqyeshme bashkërenduese; dhe
- Aftësi të mira komunikimi.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Certifikatën nga gjykata e cila dëshmon, se nuk keni qenë asnjëherë subjekt i ndonjë veprë penale (jo më të vjetër se 3 muaj); dhe
- Vërtetimin nga Policia që dëshmon se nuk jeni nën hetime (jo më të vjetër se 3 muaj).
- Dëshmi mbi identitetin dhe vendbanimin e përhershëm në Kosovë.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **01 dhjetor 2022**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org
- Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit do të kontaktohen.**



OGLAŠAVANJE SLOBODNOG RADNOG MESTA

Naziv: Novi službenik za rad sa gotovinom
Odeljenje: za novac i bankarstvo
Odsek: za gotovinu
Stepen: 7
Izveštava: upravniku Odseka za gotovinu

Dužnosti i odgovornosti:

- U koordinaciji sa šefom odseka, visokim službenicima za rad sa gotovinom i ostalim službenicima odseka pomaže u vršenju depozita i podizanja gotovine prema planu rasporeda klijenata;
- U koordinaciji sa šefom odseka, visokim službenicima za rad sa gotovinom i ostalim službenicima odseka pomaže u pripremi podizanja gotovine prema planu rasporeda klijenata;
- U koordinaciji sa šefom odseka, visokim službenicima za rad sa gotovinom i ostalim službenicima odseka prima gotovinske depozite od stranaka;
- U koordinaciji sa šefom odseka, visokim službenicima za rad sa gotovinom i ostalim službenicima odseka pomaže u procesu pripreme podizanja gotovine od stranaka;
- U koordinaciji sa šefom odseka, visokim službenicima za rad sa gotovinom i ostalim službenicima odseka evidentira u računovodstvenom sistemu dnevne transakcije gotovinom;
- U koordinaciji sa šefom odseka, visokim službenicima za rad sa gotovinom i ostalim službenicima odseka se angažuju u procesiranju gotovine;
- U koordinaciji sa šefom odseka, visokim službenicima za rad sa gotovinom i ostalim službenicima odseka učestvuje u otvaranju i zatvaranju trezora u skladu sa pravilima i postupcima;
- Pomaže šefu odseka, visokim službenicima za rad sa gotovinom i ostalim službenicima odseka tokom procesa izmirenja stanja gotovine u trezorima sa stanjem računovodstva;
- Pomaže šefu odseka, visokim službenicima za rad sa gotovinom i ostalim službenicima odseka tokom procesa pripreme, transporta i logistike gotovine;
- U koordinaciji sa šefom odseka, visokim službenicima za rad sa gotovinom i ostalim službenicima odseka se angažuje u evidenciji gotovine;
- Obavlja i druge poslove vezane za rad sa gotovinom i trezorom.

Obrazovanje:

- Fakultetska diploma;
- Poželjno je imati znanje o bezbednosnim svojstvima evro novčanica i metalnog novca kao i znanje o savremenim mašinama za procesiranje gotovine;
- Dobro poznavanje MS Office aplikacija i bankarskih aplikacija.

Radno iskustvo:

- Poželjno je radno iskustvo kao radnik na trezoru, radnik na procesiranju gotovine ili blagajnik.

Poznavanje stranih jezika:

- Odlično poznavanje albanskog i/ili srpskog jezika;
- Poželjno poznavanje engleskog jezika.

Posebni uslovi:

- da nikada nije bio predmet nekog krivičnog dela;
- visoka poverljivost;
- pažnja prema detaljima i tačnosti;
- odlične veštine koordinacije; i
- dobre komunikacijske veštine.

Svi kandidati moraju dostaviti sledeća dokumenta:

- Zvanični obrazac CBK-a za prijavu;
- Propratno (motivaciono) pismo gde se ističe interesovanje za ovaj položaj;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
- Uverenje iz suda kojim se dokazuje da nikada niste bili predmet krivičnog dela (ne starije od 3 meseca); i
- Potvrda policije kojom se dokazuje da niste pod istragom (ne starija od 3 meseca).
- Dokaz o identitetu i stalnom boravku na Kosovu.

Postupak prijavlivanja:

- Krajni rok za prijavu je **01. decembar 2022. godine**.
- Prijava se može izvršiti i putem interneta (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične stranice interneta CBK-a ili preko arhive CBK-a. Nijedan drugi obrazac za prijavu neće se uzeti u obzir.
- Obrazac za prijavu možete preuzeti sa zvanične internet stranice: www.bqk-kos.org
- Nepotpuna dokumentacija neće se razmatrati. Samo kandidati koji ispunjavaju uslove konkursa biće kontaktirani.**



Bazuar në nenin 38 të Ligjit mbi Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Paneli i Bordit të Bankës Qendrore (BQK) publikon:

Shpallje

Për plotësimin e pozitës së Guvernatorit/es të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Profili i kërkuar i kandidatit/es:

- Të jetë me integritet dhe të ketë përgatitje universitare;
- Të ketë minimum dhjetë (10) vite përvojë profesionale ose akademike në fushat e ekonomisë, financave, bankave, kontabilitetit apo çështje juridike;
- Të ketë njohuri në zhvillimin dhe implementimin e politikave të rëndësishme të lidhura me misionin, objektivat dhe detyrat e BQK-së;
- Të ketë përvojë dhe aftësi menaxheriale;
- Të përmbushë kërkesat nga neni 40 i Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës;
- Njohja e gjuhës angleze dhe gjuhëve tjera paraqet përparësi.

Emërimi do të jetë për një mandat pesëvjeçar duke filluar më 29 mars 2023 ose në datën e emërimit.

Lista e kandidatëve që kualifikohen nga ana e Panelit do t'i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës i cili do të përzgjedhë një individ. Miratimi dhe emërimi për këtë pozitë do të bëhet nga Presidenti/ja i/e Republikës së Kosovës në pajtim me nenin 84.27 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 38.2 të Ligjit të BQK-së.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë një CV me detaje dhe një letër motivuese përmes email adresës vijuese: paneli@bqk-kos.org ose në dorë në kovertë të mbyllur në Arkivin e BQK-së, ndërtesa e BQK-së, Rruga Garibaldi nr.33 në Prishtinë ose përmes postës në adresë të BQK-së: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (Shënim: për pozitën e Guvernatorit), Rruga Garibaldi nr. 33, 10000, Prishtinë, Kosovë.

Afati i fundit për aplikim është 16 dhjetor 2022.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur nga ana e Panelit do të thirren për intervistë.



Na osnove člana 38. Zakona o Centralnoj banci Republike Kosova, Panel Upravnog odbora Centralne banke (CBK), objavljuje:

Oglas

Za popunjavanje pozicije guvernera /ke Centralne banke Republike Kosova.

Traženi profil kandidata:

- Osoba sa integritetom i univerzitetskom diplomom;
- Najmanje deset (10) godina profesionalnog ili akademskog iskustva u oblasti ekonomije, finansija, bankarstva, računovodstva ili pravnih pitanja;
- Znanje u razvoju i implementaciji relevantnih politika vezanih za misiju, ciljeve i zadatka CBK-a;
- Iskustva i menadžerske veštine;
- Da ispunjava uslove iz člana 40. Zakona br. 03/L-209 o Centralnoj banci Republike Kosova;
- Poznavanje engleskog i drugih jezika je prednost.

Imenovanje će biti za jedan petogodišnji mandat koji počinje 29. marta 2023. godine ili na dan imenovanja.

Spisak kandidata koji se kvalifikuju od strane Panela će biti upućen Skupštini Republike Kosovo, koja će izabrati jednog pojedinca. Odobrenje i imenovanje za ovu poziciju donosi predsednik Republike Kosovo u skladu sa članom 84.27 Ustava Republike Kosovo i članom 38.2 Zakona o CBK-u.

Zainteresovani kandidati moraju da dostave CV sa detaljima i motivaciono pismo putem elektronske pošte: paneli@bqk-kos.org ili predaju lično u zatvorenoj koverti u Arhivi CBK-a, zgrada CBK-a, ulica Garibaldi br. 33 u Prištini ili poštom na adresu CBK-a: Centralna banka Republike Kosova (Napomena: za poziciju guvernera), ulica Garibaldi br. 33, 10000, Priština, Kosovo.

Poslednji rok za prijavu je 16. decembar 2022.

Samo kandidati izabrani od strane Panela biće pozvani na intervju.

Njoftim për mbrojtje publike të Punimit të Doktoratës

Njoftohen të gjithë të interesuarit se me datë 24.11.2022 (e enjte), prej orës 12:00, në Fakultetin Ekonomik (salla e profesorëve), kandidatja Msc. Luljeta Gllgjani i nënshtrohet mbrojtjes publike të Punimit të Doktoratës me temën: "Politika Fiskale dhe Rritja Ekonomike në Vendet në Tranzicion të Evropës Juglindore", me mentor Prof.Asoc.Dr. Driton Balaj, para komisionit profesional, në përbërje prej:

Prof. Dr. Safet Merovci- kryetar i komisionit,

Prof.Asoc. Dr. Nimete Berisha- anëtare e komisionit,

Prof. Dr. Seadin Xhaferi - anëtarë i jashtëm i komisionit (Fakulteti Ekonomik, Universiteti Shtetëror i Tetovës, Maqedoni Veriore).

Njoftim për zvogëlim kapitali

Pronarët e biznesit "Z Zanafilla Sun" SHPK me numër Unik identifikues: 811966590, Shefket Elezi dhe Zejnë Shehu kanë vendosur të bëjnë zvogëlim e kapitalit themelues nga 50.000.000 Euro në kapitalin e ri 1.000.000.

Shpallja vlen 30 ditë nga data e shpalljes.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Atmir Curri shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme SH.M.L "Dardania" Hani i Elezit.

Xheneta Lusnjani shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme SH.M.L "Dardani" Hani Elezit.

Shefqet Zogaj shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

Nail Hoxha shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

Elsin Birdaini shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

Rexhep Kastrati shpall te pavlefshme 3 dëftesa, certifikatën, diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

Melisa Malaj nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e testit të maturës në Gjimnazin "Hajdar Dushi".

Halil Qamil Xharavina nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e U. Prishtinës "Hasan Prishtina" Fak. Shkenc. Sportive me nr. 645.

Fatum Gecaj shpalle të pavlefshme diplomën me numër : 442/18 të lëshuar nga Diakonie Training Center.

D.P.T Bardhi shpall të pavlefshme certifikatën e Biznesit me nrb :810556136.

Armend Hasani shpalle të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e gjimnazit " Frang Bardhi".

- Infermierja e përgjithshme, Rabe Nikçi nga komuna Pejës me numër personal 1003700182, shpalli të humbur Licencën e Punës me numër: KO-3462-05-20, me afat prej 03.01.2018 deri 03.01.2023.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188



ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1905

Columbus, Georgia, USA
0.5L